



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Ligjshmërisë

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT TË ZGJEDHËSVE,
NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Bazuar në nenit 20, pika 1, shkronja “ë”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij, për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre.

Në referim të nenit 20, pika 2, shkronja “c” të Kodit Zgjedhor, Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së, për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte apo procedura të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi.

Referuar nenit 22 Kodit Zgjedhor, KQZ-ja ka kompetencë të eksplorojë, eksperimentojë dhe të vendosë përdorimin në zgjedhje të sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit, për të mbuluar aspekte dhe/ose procedura të veçanta të procesit zgjedhor, të angazhojë konsulencë të huaj për këtë qëllim, si dhe të prokurojë sisteme apo pajisje të teknologjisë së informacionit apo edhe shërbimin e operimit të tyre.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator, që procesi i votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit të zgjedhësve (PEVN), në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: .4.2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT TË ZGJEDHËSVE, NË
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13864, datë 24.10.2022, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", nenit 20, pikat 1, shkronja "ë" dhe 2, shkronja "c", si dhe nenit 22 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, procesi i votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit të zgjedhësve (PEVN), në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data:..2023 Nr:
Ora:



"Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit të zgjedhësve, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"